

FERMALT

Përzierje e hollë çimentoje pasivizuese antikarbonatizuese

Karakteristikat

FERMALT është një parapërzierje e përbërë nga lidhje çimentore, inerte siliciumi të përzgjedhura, shtesa kimike antikarbonatizuese dhe rrëshira sintetike.

Kur përdoret mbi sipërfaqe betoni të degraduar, me hekurat armaturash të ekspozuara e të oksiduara, krijon mbi hekurat një shtresë mbrojtëse alkalino-pasivizuese dhe një bazë antikarbonatizuese për t'u kapur mbi beton për ta restauruar me llaçe të tipit PRORES, PROMALT, PRORIP

Fusha e përdorimit

Trajtim paraprak dhe kurativ i hekurave të armaturës së betonit nga dukuria e gërryerjes e shkaktuar nga veprimi shpërbërës i CO₂ dhe SO₂, të cilët bashkë me lagështirën e ajrit, shkaktojnë humbjen e shkallëzuar të alkalinitetit të betonit duke favorizuar kështu dukurinë e oksidimit të hekurave të armaturës, që me rritjen e vëllimit shkakton shpërbërjen e sipërfaqes së hekurit.

Avantazhet

- Formuar nga një përbërës, pa humbje
- Ngjitje e përsosur me çdo lloj sipërfaqe solide prej betoni apo hekuri
- Qëndrueshmëri e lartë ndaj veprimit të agjentëve atmosferikë
- I kollajtë në përdorim

Përgatitje e sipërfaqeve

Sipërfaqet duhen të jenë të staxhionuara, solide, të pastërta dhe pa pluhur.

Duhen hequr gjurmët e vajërave dhe të yndyrërave, pjesët që janë duke rënë apo që nuk janë të kapura mirë.

Të hiqet betoni i karbonatizuar derisa të dalë në sipërfaqe hekuri i paoksiduar.

T'u bihet me furçë, të zmerilohen ose të spërkaten me rërë me kujdes hekurat e zbuluar derisa të hiqet çdo gjurmë ndryshku; të lahet sipërfaqia me kujdes.

Mënyra e përdorimit

Përziej një kovë prej 5 kg FERMALT me rreth 1.2 l ujë të pastër me trapon përzierës ose mistri, derisa të përftohet një përzierje homogjene, pa kokrriza dhe viskoze. Pas 10 min të përziejehet përsëri për një kohë të shkurtër dhe me penel të lyhen hekurat me tënë një shtresë të vazhdueshme të paktë 1mm. Pas një orë t'i jepet një dorë e dytë rreth 2 mm duke ia veshur edhe betonit përreth, në mënyrë që të realizohet një kapje me restaurimin pasues të sipërfaqes së hekurit, për t'u realizuar kjo me llaçe të tipit PRORES, PROMALT, PRORIP pas dy orësh.

Të dhëna teknike dhe aplikative

* Pamja	pluhur ngjyrë gri e kuqërremtë
* Peshë specifike e llaçit të freskët	rreth 2.100 kg/m ³
* Ambalazhimi	kovë 5 kg
* Konsumi i mesëm/mm trashësi	1.7 kg pluhur/m ²
* Uji i përzierjes	23-25 %
* Qëndrueshmëria në shtypje (28 ditë)	50 N/mm ²
* Qëndrueshmëria në përkulje (28 ditë)	5.0 N/mm ²
* Ngjytja për beton pas 28 ditësh	2.5 N/mm ²
* Afati i përdorimit të përzierjes 20° C rreth 30 min	
* Diametri max inert	0.6 mm
* Koha e përzierjes	2-3 min
* Trashësia max për çdo kalim	1-2 mm
* Trashësia max përfundimtare	2-3 mm
* Temperatura e përdorimit	+5 / +35° C
* Koha e ruajtjes	12 muaj nëse mbahet në vend të thatë e të freskët në ambalazhin original të vulosur
* Vegla	Trapon përzierës, brushë

Paralajmërimë

- ** Mos e përdor mbi sipërfaqe tepër të nxehta, ku fryn erë e fortë apo në pishë të diellit
- ** Mos e përdor mbi sipërfaqe të ngrira ose që mund të ngrihen gjatë 24 orëve të ardhshme
- ** Mos e përdor mbi sipërfaqe të bojatisura
- ** Mos e përdor si produkt finiture kundër ndryshkut
- ** Mos i shtoj ujë, çimento apo ndonjë produkt tjetër produktit të përzier
- ** Pastroji veglat me ujë para se produkti të ngrihet

Qëndrueshmëri mekanike:

Qëndrueshmëritë mekanike, të pasqyruara në tabelë, janë nxjerrë nga mostra 4 x 4 x 16 cm, të ambalazuara në laborator me 17.5 % ujë dhe të maturuara në 20°C dhe U.R. 90%. Të dhënat mund të ndryshojnë ndërkohë që ndryshojnë kushtet e përzierjes e të staxhionimit.

Vërejt!

Vlera të tilla u referohen provave laboratorike në mjedis të kushtëzuar dhe mund të modifikohen ndjeshëm nga kushtet e vënies në përdorim.